

# Përkthimi i Dialogëve

---

## Mësimi 1

### Muzika është e shkëlqyer!

*Së pari ju dëgjoni një fragment kënge. Këngën e këndon Marlenë Ditrih (1901–1992), aktore dhe këngëtare e famshme me origjinë gjermane. Për arsye të së drejtës së autorit, teksti i këngës nuk është përkthyer.*

*Situata 1. Disa njerëz kanë qendruar në rrugë dhe po dëgjojnë një muzikant rruge. Ata komentojnë muzikën.*

Gruaja 1: Ua, sa bukur!  
Gruaja 2: Fantastike!  
Djali 1: Po, muzika është e shkëlqyer!

*Situata 2. Njëri nga personat që po dëgjojnë muzikën kërkon një cigare.*

Djali 2: Ke një cigare?  
Djali 1: Çfarë kërkon?  
Djali 2: A ke një cigare?  
Djali 1: Po, merre.

*Situata 3. Por tani i riu kërkon diçka për të ndezur cigaren.*

Djali 2: A ke shkrepëse?  
Djali 1: Shkrepëse? Jo, nuk kam.  
Një burrë: Prit, kam unë shkrepëse.  
Djali 2: Falemnderit!

## Mësimi 2

### Emri im është Eksa

*Në mësimin e dytë prezantohen personazhet kryesore të kursit të gjermanishtes. E para prezantohet zonja Berger, drejtoresha e hotelit.*

Frau Berger: Pra, emri im është Berger. Liza Berger. Unë jam shefja këtu, jam drejtoresha e hotelit "Evropa".  
Ex: Asaj i pëlqen të këndojë!  
Frau Berger: Po, është e vërtetë!

*Pastaj prezantohet Eksa, një personazh imagjinar femëror, një vitore e vogël. (Në origjinal, fjalët e Eksës janë dbënë me rimë.)*

Ex: E di çdo njeri, si më quajnë mua,  
Eksa është emri im – unë jam grua,  
Dot nuk më shihni, këtë askush s'e kupton,  
Po kushdo mund të betohet, që mua më dëgjon.  
Andreas: Dhe ajo është shumë e aftë të shqetësojë të tjerët.

*Personazhi i tretë është Andrea Shefer. Ai është sportelist në hotelin "Evropa". Veç kësaj ai studion për gazetari.*

Andreas: Pra, unë jam Andrea, Andrea Shefer. Edhe unë punoj në hotelin "Evropa". Jam sportelist këtu.  
Ex: Po ti je edhe student!  
Andreas: Natyrisht, Eksa. E di që jam student!  
Ex: Por jo të gjithë dëgjuesit e dinë.  
Andreas: Por tani do ta dinë! *(Në mënyrë formale)* Unë jam Andrea Shefer, unë punoj si sportelist dhe studioj për gazetari. Mjafton kaq?  
Ex: *(vetëm kollitet)*

*Hana Klazen është punëtore pastrimi në Hotel Evropa.*

Hanna: Unë e kam radhën?  
Ex: Po!  
Hanna: Mirë, unë quhem Hana. Hana Klazen. Unë jam punëtore pastrimi në hotelin "Evropa". Puna këtu më pëlqen. Vijnë kaq shumë njerëz në hotel ...  
Ex: *(pak me ironi)* Dhe ata janë gjithmonë kaq të mirë!

*Dr. Tyrmani, që jeton në Berlin, është një klient i rregullt i hotelit "Evropa".*

Dr. Thürmann: Tani – jo gjithmonë! Por unë jam një nga njerëzit e mirë, jam edhe pak i vjetër. Shkurt, unë jam klient i hotelit "Evropa". Vij shpesh këtu në Ahen, por jetoj në Berlin.  
Ex: *(me padurim)* Emri juaj!  
Dr. Thürmann: Më falni, si thatë?  
Ex: Si quheni?  
Dr. Thürmann: Ah, po. Unë quhem Tyrman.  
Ex: Pra, ky është dr. Tyrmani. Ai është pak i rëndë nga veshët.

### **Mësimi 3** **Më merr edhe mua?**

*Andrea e ka pushim fundjavën. Ai përsëendetet me kolegët e punës. Ai do të shkojë në Bruksel dhe do të marrë me vete edhe Hanën, punëtoren e pastrimit.*

Andreas: Atëherë, kalofshi një fundjavë të mirë, zonja Berger!  
 Frau Berger: Falemnderit, gjithashtu! Kalofshi bukur në Bruksel!  
 Andreas: Falemnderit.  
 Hanna: Çfarë? Ti do të shkosh në Bruksel?!  
 Andreas: Po, kam një takim atje.  
 Hanna: Po mirë, me makinë do të shkosh?  
 Andreas: Po.  
 Hanna: Unë dua të vizitoj një shoqe në Bruksel. Më merr edhe mua?  
 Andreas: Sigurisht! Unë nesër në mëngjes, në orën 8. Vij të marr në shtëpi.  
 Hanna: Mrekulli! Shumë falemnderit, Andrea. Mirupafshim nesër.  
 Andreas: Mirupafshim nesër!

*Gjatë udhëtimit për në Bruksel, Andream e ndalon policia. Ai i ka dhënë makinës më shpejt se sa lejohet.*

Andreas: Mos! Edhe kjo më duhej tani!  
 Hanna: Ç'ka ndodhur?  
 Andreas: Policia! Shpresoj të arrij në kohë në takim. *(Andrea ndalon makinën.)*  
 Polici: Mirëdita! Kontrolli i qarkullimit rrugor. Dokumentat, ju lutem! Ndizini dritat! Mirë, çdo gjë në rregull. E dini se sa shpejt po e ngisnit makinën, zoti Shefer?  
 Andreas: Nuk e di.  
 Polici: 130 (km/orë)!  
 Andreas: Ka shumë mundësi.  
 Polici: Po këtu ju lejoheni t'i jepni makinës vetëm me 100 km/orë. Nuk e patë tabelën?  
 Andreas: Jo. Më falni.  
 Polici: Po, por kjo nuk ju ndihmon. Kjo që bëtë ju kushton 80 marka.

#### **Mësimi 4**

#### **A keni një hartë qyteti?**

*Dy bashkëshortë arrijnë në stacionin kryesor hekurudhor të Ahenit. Ata shkojnë në fillim në zyrën e informacionit për turistët.*

Lajmërim nga altoparlanti: Ahen. Stacioni kryesor i Ahenit. Ky tren nuk shkon më tej. Udhëtimin mund ta vazhdoni me trenin për në Këln, nisja ora 18.02, platforma 3.

Herr Frisch: Më në fund! Eja, na duhet një hartë e qytetit.  
 Frau Frisch: Ke ndërmend ta blesh?  
 Herr Frisch: Jo. Nuk e sheh gjërmën? Atje është zyra e informacionit për turistët. Me siguri që do të ketë edhe ndonjë hartë qyteti.  
 Nëpunësi: A mund t'ju ndihmoj?  
 Herr Frisch: Po, ju lutem. A keni një hartë qyteti?

Nëpunësi: (*shpalos një bartë qyteti*) Po, natyrisht. Shikoni, ju lutem: Këtu është stacioni kryesor i trenave. Këtu ku jeni ju tani. Dhe këtu është qendra e qytetit. Meqë ra fjala, keni gjetur hotel?  
 Frau Frisch: Po, hotelin “Evropa”.  
 Nëpunësi: Është këtu fare pranë.  
 Herr Frisch: Ç’lehtësi!  
 Frau Frisch: Epo, mrekulli! Falemnderit shumë!

*Dy bashkëshortët arrijnë në Hotelin Evropa dhe pyesin nëse ka ndonjë restorant pranë hotelit.*

Herr Frisch: Mund të na rekomandoni një restorant këtu afër?  
 Andreas: Me gjithë qejf! Menjëherë pas kthesës është një piceri.  
 Herr Frisch: A, mirë. Mua gjithmonë më shijon kuzhina italiane!  
 Frau Frisch: Oh, jo, seriozisht jo. Piceri mund të gjesh kudo.  
 Andreas: Ndoshta do t’ju pëlqente të provonit një restorant francez?  
 Frau Frisch: Jo, falemnderit. Do të na pëlqente një restorant gjerman.  
 Andreas: Atëherë mund t’ju rekomandoj restorantin *Postwagen*.  
 Gatuajnë mirë dhe çmimet janë të arsyeshme.  
 Herr Frisch: Falemnderit! Po e provojmë njëherë.

## Mësimi 5

### Unë po servir pijet

*Andrea ka organizuar një mbrëmje për të festuar datëlindjen. Ai ka ftuar shokët në shtëpi.*

Shokët: (*këndojnë*) Happy birthday to you ...  
 Shoqja: Gëzuar ditëlindjen!  
 Shoku 1: Urime!  
 Andreas: Falemnderit! Po hyni brenda!  
 Shoku 1: Kjo është një dhuratë për ty!  
 Shoqja: Dhe ja edhe një dhuratë tjetër!  
 Shoku 2: Edhe një tjetër!  
 Andreas: Falemnderit! (*Fillon të hapë dhuratat*) Pllakati është shumë i bukur! Falemnderit, Martin! Po këtu brenda, çfarë ka?  
 Shoqja: Hape njëherë!  
 Andreas: (*lexon:*) Skorpioni (Akrepit).  
 Freundin: Është një horoskop, Andrea. Horoskopi yt. Ti je i shenjës së Akrepit, në fund të fundit.  
 Andreas: Po, ashtu është. (*Fillon të lexojë:*) Njeriut të lindur në shenjën e Akrepit i pëlqen fshehtësia. Ai do të zbulojë atë që fshihet pas sipërfaqes së fenomeneve. Ai dëshiron ...  
 Shoqja: Duhet ta lexosh në qetësi.  
 Andreas: Dhe pastaj do të di gjithçka për veten?  
 Shoqja: Ndoshta.

*Andrea i fton miqtë e tij të hanë dhe të pinë diçka ...*

Andreas: Atëherë – këtu ka për të ngrënë.  
 Shoqja: Fantastike! Më ka marrë shumë uria.  
 Andreas: Ja gotat dhe pirunjtë, thikat e lugët.

Shoku 1: Unë po servir pijet. Kush do lëng frutash?  
 Shoku 2: Unë!  
 Shoqja: Po verë, ka?  
 Andreas: Ta merr mendja! Do verë të kuqe apo të bardhë?  
 Shoqja: Po pi verë të kuqe.  
 Shoku 1: Më duhet një pecetë. A ka ndonjë këtu?  
 Shoqja: Ku janë pjatat? Nuk ka më pjata!  
 Shoku 2: Ka, ja ku janë! A ka muzikë këtu?  
 Andreas: Si jo!

## Mësimi 6

### Ai nuk di datëlindjen e vet?

*Andrea falënderon zonjën Berger për librin që ajo i dburoi për datëlindje.*

Frau Berger: Mirëmëngjes, zoti Shefer!  
 Andreas: Mirëmëngjes, zonja Berger. Ju falemnderit për librin!  
 Hanna: Për cilin libër?  
 Frau Berger: Zoti Shefer kishte dje datëlindjen dhe ...  
 Hanna: Kishe datëlindjen? Atëherë urime, megjithëse me vonesë!  
 Andreas: Falemnderit! Më pëlqen veçanërisht një tregim në libër.  
 Frau Berger: Cili tregim?  
 Andreas: Historia e Shinasi Dikmen-it. Titullin e ka: Kein Geburtstag, keine Integration. *(Pa datëlindje nuk ka integrim.)*  
 Hanna: Si?  
 Andreas: Historia e një turku. Ai nuk e di datën se kur ka lindur.  
 Hanna: Çfarë? Ai nuk di datëlindjen e vet?

*Andrea tregon një histori të një autori turk, Shinasi Dikmen. Historia është shkëputur nga libri me titull "Kein Geburtstag, keine Integration" (Pa datëlindje nuk ka integrim)*

Andreas: Tregimi fillon kështu: Unë s'kam datë të lindjes. Natyrisht ka një datë në pasaportën time. Por ajo nuk është datëlindja ime e vërtetë. Është datëlindja zyrtare.  
 Hanna: Po më tej?  
 Andreas: Dikmen pyet në fillim nënën. Ajo mendohet e mendohet dhe pastaj thotë: "Atë ditë u zhduk bualli ynë" Dhe ajo tregon e tregon për buallin ... Por dita dhe stina nuk i kujtohen më.

*Dikmen vazhdon përpjekjet për të mësuar ditën e tij të lindjes. Të gjithëve atyre që ai pyet u kujtohet nga një histori, e cila ka ndodhur ditën e lindjes se tij, por datën e saktë së kur ka lindur Dikmen nuk e di askush.*

- Andreas: Dikmen pyet të motrën. Ajo thotë: “Natyrisht që e di. Atë ditë e pashë burrin tim për herë të parë”. Dhe ajo tregon e tregon ... Por ditën dhe kohën e vitit se kur ka lindur Dikmen ajo nuk e mban mend. Dikmen pyet kunatin e tij. Dikmen pyet mësuesin e tij. Dikmen pyet më të moçmin e fshatit. Të gjithëve atyre u kujtohet nga një ngjarje, por Dikmen nuk e zbulon datën e lindjes.
- Hanna: Kjo është e çuditshme.
- Andreas: Jo, ky është vetëm një rast i ndryshëm!

## Mësimi 7

### M'i jep, të lutem, broshurat!

*Dy bashkëshortë po shfletojnë disa broshura me informacione për turistët që vizitojnë Ahenin.*

- Herr Frisch: Ti sikur ke një broshurë për Ahenin?
- Frau Frisch: Një? Unë kam katër!
- Herr Frisch: M'i jep, të lutem, broshurat!
- Frau Frisch: Po, një minutë. – Ja ku i ke!
- Herr Frisch: *(shfleton broshurat dhe lexon me zë të lartë)* Zbuloni Ahenin! Ahenin – qytetin në zemër të Evropes, fare ngjitur me Hollandën dhe Belgjikën.
- Frau Frisch: Po këtë e dimë!
- Herr Frisch: Aheni – qendër e artit.
- Frau Frisch: Jo interesante!
- Herr Frisch: Aheni – qytet kurativ dhe me banja e pishina.
- Frau Frisch: S'kemi nevojë për këto.
- Herr Frisch: Aheni – qendër kongresesh.
- Frau Frisch: Unë mund të punoj në shtëpi.
- Herr Frisch: Aheni ju ofron shumë gjera.
- Frau Frisch: E ç'po më ofron ti?
- Herr Frisch: Aheni – qytet me nuhatje. Qyteti është një paradisi për blerësit. Ja, kjo është diçka për ty.
- Frau Frisch: Mirë, pa të shohim njëherë.
- Herr Frisch: Ne u japim me gjithë qejf vizitorëve tanë informacione të tjera.

*Zonja Frisch lexon një broshurë tjetër.*

- Frau Frisch: *(lexon)* Ne do t'ju tregojmë Ahenin! Zbuloni të sotmen dhe të shkuarën! Shëtitja jonë fillon tek katedralja. *(I drejtobët të shoqit)* Ja, kjo është për ty! *(Vazhdon leximin:)* Ato që ju duhen për rrugë janë humori i mirë, ca para natyrisht – dhe mos harroni syzet! *(I drejtobët të shoqit)* Ti gjithnjë i harron syzet. Ja – po t'i jap që tani. Vëri menjëherë në xhep! *(Vazhdon leximin)* Dhe mund të nisemi në çast.
- Herr Frisch: Dakord, le të shkojmë atëherë!

## Mësimi 8

### S'kam asnjë lajm prej saj

*Andrea, dr. Tyrmani dhe zonja Berger janë ulur në një kafene. Ata flasin për Eksën, për vitoren e paduksbme, e cila u zhduk gjatë një ekskursioni të përbashkët.*

- Dr. Thürmann: Si është puna me zërin tuaj të dytë?  
Frau Berger: Po, si është puna me Eksën? Është kthyer?  
Andreas: Jo – për fat të keq jo. S'kam asnjë lajm prej saj.  
Frau Berger: Vërtet, ajo u zhduk atëherë! Po pse vallë?  
Andreas: S'e di fare!  
Dr. Thürmann: Më thoni: Ç'është kjo histori me zërin tuaj të dytë – Eksën?  
Nuk kuptoj më asgjë.  
Andreas: Epo mirë, unë do t'ua tregoj historinë. Por – kjo histori është e çuditshme, është si përrallë ...  
Frau Berger: Po tregoheni njëherë! As unë nuk e di këtë histori.

*Andrea flet për mbremjen kur u shfaq papritur Eksa. Ai ndodhej në shtëpi duke lexuar librin me titull “Shpirtrat e Mirë të Këlnit” (Heinzelmännchen zu Köln). Sipas gojëdhënës, vitorët (apo karkanxhollët) Hajncelmenhen vinin natën dhe mbaronin punën që zejtarët nuk e kishin mbaruar ditën.*

- Andreas: Isha në shtëpi, duke dëgjuar muzikë dhe duke lexuar librin “Shpirtrat e mirë të Këlnit”. Natën, shpirtrat e mirë Hajncelmenhen bënin punën e njerëzve. Dhe unë fillova të ëndërroja dhe të uroja që edhe unë të kisha një ndihmë të tillë.  
Dr. Thürmann: Dhe pastaj?  
Andreas: Pastaj u shfaq Eksa.  
Dr. Thürmann: Ç'doni të thoni me “u shfaq”?  
Andreas: Dëgjova një zë, por nuk pashë askënd. Ajo thjesht u shfaq.  
Frau Berger: Pra ajo doli nga libri juaj?  
Andreas: Po. Dhe prandaj unë e quajta Eks. Eks në latinisht do të thotë “nga”.  
Frau Berger: Me një fjalë, ky është zëri juaj i dytë!?  
Dr. Thürmann: Historia është në fakt e çuditshme – dhe magjepsëse.

## Mësimi 9

### I këndova një këngë

*Dr. Tyrmani, zonja Berger dhe Andrea kujtojnë ekskursionin e tyre me anije. Eksa ishte me ta atë ditë.*

- Dr. Thürmann: Ne bëmë bashkë një shëtitje me anije.  
Andreas: Eksa ishte shumë e gëzuar.  
Frau Berger: Pastaj ne kaluam para shkëmbit “Lorelaj”.

Andreas: Dhe papritur Eksa tha: "Lorelaj? Unë e njoh atë! Ajo ishte shumë e bukur!"

Frau Berger: Dhe unë i këndova asaj këngën e *Lorelajt*.

Andreas: Pastaj kapiteni i anijes tha: (*imiton ciceronin – kapiten të anijes*) Në shkëmb kishte përpara një shpellë. Dhe atje jetonin shpirtat Hajncelmenhen.

Dr. Thürmann: Sipas gojëdhënës!

*Të tre vrasin mendjen se çfarë mund t'i ketë ndodhur Eksës që u zhdruk atë ditë.*

Andreas: Unë menjëherë e pyeta Eksën: Eksa, e dije ti këtë? Por – ajo nuk u përgjegj. Në fillim ajo u shfaq pa e zgjatur – kurse tani është zhdukur.

Dr. Thürmann: Hm.

Frau Berger: Po – po kjo është fare e qartë!

Andreas: Çfarë?

Frau Berger: Ajo po kërkon shpirtat Hajncelmenhen!

Andreas: Si kështu?

Dr. Thürmann: Pra, kjo është historia juaj: Eksa dhe shpirtat Hajncelmenhen!

Andreas: Ndoshta. E çfarë duhet të bëj unë tani?

Frau Berger: (*qesh*) Të prisni dhe të mendoheni përsëri!

Andreas: (*me vete*) Mua më pëlqen kaq shumë ajo.

Dr. Thürmann: Ju e dini që unë nesër do të nisem për në Berlin. Mor djalë: Ejani me mua në Berlin – me ose pa Eksën!

## Mësimi 10

### Dëshiroj të rezervoj një dhomë

*Rezervimi i një dhomë është zakonisht diçka e thjeshtë ...*

Burri: Mirëdita. Emri im është Sherer. Dëshiroj të rezervoj një dhomë dyshe, prej datës 1 deri më 3 maj.

*Por rezervimi i një dhomë edhe mund të ndërlikohet – siç i ndodhi një gruaje, e cila telefonoi nga Frankfurti në Hotelin Evropa për të rezervuar një dhomë për familjen e saj.*

*(Bie zilja e telefonit)*

Andreas: Hotel Evropa. Mirëdita.

Frau: Mirëdita. Beker është emri im. Po ju telefonoj nga Frankfurti. Një shoqja ime dikur ka qendruar në hotelin tuaj dhe ishte shumë e kënaqur.

Andreas: Kjo më gëzon. Ç'mund të bëj për ju?

Frau: Im shoq më tha që t'ju telefonoja juve. Edhe ne duam të vijmë në Ahen. Prandaj unë dëshiroj të rezervoj një dhomë. Do të vijmë me dy fëmijë. A mund të flenë ata në dhomën tonë?

Andreas: Po, natyrisht. Ky nuk është problem.  
*(Dëgjohen të leburat e një qeni.)*



Frau: Pusho, Belo! Natyrisht, edhe ti do të vish me ne. Po do të vijë edhe Belo.

Andreas: Belo? E keni fjalën për qenin tuaj?

Frau: Po, nuk e dëgjuat?

Andreas: Po. E dëgjova. Por ky është një problem. Qentë zakonisht nuk lejohen në hotel.

*Andrea interesohet se kur do të vijë familja Beker dhe sa kohë dëshiron ajo të qendrojë në hotel.*

Frau: Por Beloja ynë është shumë i urtë.

Andreas: Po, hm, kur dëshironi të vini?

Frau: Në maj, në fillim të majit, të premten.

Andreas: Doni të thoni të premten, në datën 1 maj?

Frau: Po.

Andreas: Dhe sa kohë do të qendroni?

Frau: Deri të djelën. Të hënën na duhet të kthehemi prapë në punë.

Andreas: Në rregull, atëherë një dhomë për katër vetë.

Frau: Dhe Beloja!

Andreas: Për fundjavën e 1 majit. Por më duhet të flas më shpejt për Belon. Po të me jepni numrin e telefonit tuaj do t'ju njoftoj.

Frau: Po, prefiksi i Frankfurtit është 069, dhe pastaj 98 21 41.

Andreas: Ju falemnderit. Mirupafshim.

## Mësimi 11

### Ajo hidhte bizele

*Tregimi i këtij mësimi bazohet thjesht në fantazi: Eksa u bën një vizitë Hajncelmenbenuve (Spirtrave të Mirë të Këlnit). Eksa shkoi tek Andrea duke dalë nga libri që tregon legjendën e vitoreve Hajncelmenben (Heinzelmännchen) të Këlnit. Eksa do të dijë se pse Hajncelmenben nuk i ndihmojnë më njerëzit.*

Ex: Përshëndetje, Hajncelmenben. Ja ku jam prapë!

Heinzelmännchen: Çfarë surprize! Po ti nga vjen?

Ex: Unë tani jetoj tek njerëzit.

Heinzelmännchen: Ti e ke fjalën tek një njeri.

Ex: Po, e ku e di ti këtë?

Heinzelmännchen: Ky është sekreti im.

Ex: Po ju tani, me se merreni?

Heinzelmännchen: (me shaka) Më thuaj, dëshiron të marrësh ndonjë intervistë? Edhe ti je bërë gazetarë?

Ex: Jo! Por, të lutem, më shpjego: Pse nuk i ndihmoni më njerëzit? Çfarë ndodhi atëherë?

*Eksa e zbulon të gjithë historinë: kureshtare për të mësuar misterin e spirtrave Hajncelmenben, gruaja e një rrobaqepësi hodhi nëpër shkallët e shtëpise së saj bizele. Nga zburma e shkëlqes së bizeleve ajo shpresonte të zgjohet për të parë se kush e bënte punën e burrit të saj natën.*

Heinzelmännchen: Atëherë, atëherë ... Puna ishte kështu: ne punonim për njerëzit. Edhe për rrobaqepësin. Në qepnim rroba për të. Por gruaja e tij ishte shumë kureshtare.

Ex: Si unë!

Heinzelmännchen: Po, si ti! Po ajo ishte edhe e keqe. Ajo idhte bizele nëpër shkallë - shumë, shumë bizele. Ne pengoheshim në to dhe na shkakttoheshin dhimbje.

Ex: Po pse hidhte bizele ajo?

Heinzelmännchen: Ne e kishim zakon të punonim natën. Por gruaja e rrobaqepësit donte të na shihte me çdo kusht. Ne u penguam - dhe ajo na dëgjoi. Ajo ndezi dritën ... Atëherë ne u zhdukëm me shpejtësi.

Ex: Për gjithmonë?

## Mësimi 12

### Dikush duhej të thoshte fjalën magjike

*Eksa zbulon sekretin e ligjit të vitoreve dhe elfëve: ata dubet të mbeten të padukshëm për qeniet njerëzore.*

Heinzelmännchen: Askush nuk mund të na shihte. Askush nuk duhej të na shihte.

Ex: Po pse? Pse nuk duhej t'ju shihte askush?

Heinzelmännchen: Ne donim të mbeteshim të padukshëm për njerëzit. Ky është ligji i vitoreve! Edhe ti do të mbetesh e padukshme, Eksa - apo jo?

Ex: *(e frikësuar)* U po, me çdo kusht!

*Eksa mëson nga Hajncelmenben si dhe pse ajo iu shfaq Andreas.*

Ex: Të lutem, më thoni: Nga vij unë?

Heinzelmännchen: Fare e thjeshtë, Eksa: Ne të fshehëm në librin e vitoreve Hajncelmenhen.

Ex: Mua?

Heinzelmännchen: Po, një vitore femër - po aq kureshtare sa edhe gruaja e rrobaqepësit.

Ex: Dhe po aq e keqe sa ajo?

Heinzelmännchen: Këtë duhet ta vendosësh vetë. Dikush duhej ta thoshtë fjalën magjike. Dhe atëherë ti duhej ta lije librin dhe të jetoje me njerëzit - dhe të qendroje po aq e padukshme, siç jemi ne.

Ex: Dhe cila është fjala magjike?

Heinzelmännchen: Këtë duhet ta gesh vetë! Andrea e tha fjalën magjike. Prandaj ti je me të tani.

Ex: Aha, me të vërtetë?!

## Mësimi 13

### Ku e kishit parkuar makinën?

*Njëri nga klientët e Hotel Evropës vjen tek sporteli i hotelit. Ai është i mërzitur, sepse makina e tij nuk ndodhet më aty ku e ka parkuar ai. (Hotelgast = Klient i hotelit)*

- Klienti: Makina ime është zhdukur!  
Andreas: Është zhdukur makina juaj? Jeni krejt i sigurtë?  
Klienti: Natyrisht! Natyrisht që jam i sigurtë! Në fund të fundit unë sytë në ballë i kam.  
Andreas: Mendohuni mirë: Ku e kishit parkuar makinën?  
Klienti: Në Bismarkshtrase. Menjëherë pas kthesës.  
Andreas: Oh, po atje ndalohej parkimi!  
Klienti: Çfarë? Këtë nuk e besoj. Unë nuk pashë ndonjë tabelë.  
Andreas: Mund t'jua tregoj unë.  
Klienti: Ju lutem, ma tregoni. Dua ta shoh.  
(*Andrea dhe klienti dalin në rrugë.*)  
Andreas: Ja – shikoheni :Ndalohej parkimi nga ora 15<sup>oo</sup> – 18<sup>oo</sup>.  
Klienti: Kjo nuk është e mundur!

*Klienti e kishte parkuar makinën në një rrugë me trafik të dendur. Prandaj Andrea mendon se atij ia kanë larguar makinën që andej. Policia shpesh i largon makinat, të cilat nuk parkohen në vende të lejuara, sidomos kur ato pengojnë lëvizjen e trafikut.*

- Andreas: Për sa kohë e kishit lënë makinën të parkuar atje?  
Klienti: Vetëm për një kohë të shkurtër. Me një fjalë, unë prita gruan, parkova makinën dhe çova gjërat e saj në hotel.  
Andreas: Dhe pastaj u kthyet menjëherë në hotel?  
Klienti: Jo, jo menjëherë.  
Andreas: Sa qendruat në dhomën tuaj?  
Klienti: Punonjës policie jeni ju, apo çfarë?  
Andreas: Jo, natyrisht jo. Por – ndoshta makinën tuaj e kanë hequr nga ai vend.  
Klienti: E si mund ta marr tani makinën time?  
Andreas: Duhet të telefoni vërtet në polici.  
Klienti: Pse nuk ma thatë menjëherë këtë?  
Andreas: Çfarë?  
Klienti: Punën e ndalimit të parkimit! Këtij i thonë shërbim hoteli ...

## Mësimi 14

### Atëherë u vajti mendja tek Frederiku

*Zonja Berger i tregon Andreas një ndodhi nga libri me titull "Frederik", i autorit italian Leo Lioni. Aty flitet për një familje minjsh fushe, që mblidhte ushqim për dimër. Njëri nga minjtë, Frederiku, mblidhte diçka të veçantë: rreze dielli, ngjyra dhe fjalë.*

Frau Berger: Na ishte njëherë një familje minjsh fushe. Verës po i vinte fundi dhe ata filluan të mblidhnin rezerva për dimër. Ata grumbullonin grurë, arra, gështenja, bajame dhe kashtë. Vetëm njëri nga minjtë, Frederiku, nuk bënte asnjë punë: Frederiku. “Frederik”, e pyetën minjtë e fushës, “pse nuk po bën asnjë punë?” “Unë po punoj”, tha Frederiku, “po mbledh rreze dielli për dimër.” Pak më vonë ata pyetën: “Frederik, po tani, çfarë po bën?” “Unë po mbledh ngjyra”, tha ai. Dhe pak më vonë, minjtë e pyetën Frederikun: “Frederik, je duke ëndërruar?” “Jo”, tha Frederiku, “unë po mbledh fjalë për dimër.”

*Dimri erdhi dhe ishte i gjatë. Ushqimet e minjve mbaruan. Atëherë Frederiku solli ushqimet e tij të veçanta për dimër dhe ua dhuroi minjve të tjerë.*

Frau Berger: Dimri erdhi dhe papritur u bë shumë ftohtë. Atëherë minjve u vajti mendja tek Frederiku. “Frederik, si po duken ato rezervat e tua?” pyetën minjtë. “Mbyllini sytë”, tha Frederiku, “tani do t’ju dërgoj rrezet e diellit.” Minjtë e fushës i mbyllën sytë dhe ndienë ngrohtësinë. “Po ngjyrat?” pyetën minjtë e fushës. “Mbyllini prapë sytë”, tha Frederiku. Dhe ai u foli minjve të fushës, për lulet e kuqe dhe për lulet blu dhe për kashtën e verdhë. Minjtë e fushës i mbyllën sytë dhe panë ngjyrat. “Po fjalët?”, pyetën minjtë e fushës. Atëherë Frederiku mori fjalët dhe tregoi një histori për minjtë ... Historia ishte shumë e bukur. Minjtë e fushës u entuziazmuan dhe thirrën: “Frederik, po ti qenke poet!”

## Mësimi 15

### E padukshme dhe e paturpshme

*Andrea është i mërzitur. Ai ndodhet në shtëpi dhe po mendon për Eksën. Sapo ai shqipton fjalën magjike sowieso, Eksa shfaqet papritur përsëri.*

Andreas: (me vete) Oh Eksa, ja ku e kam librin e shpirtrave Hajncelmenhen, kurse ti, ti – je zhdukur! Sa keq! Kjo më dëshpëron. Sidoqoftë, ti ndoshta nuk ke qenë e lumtur tek unë.

Ex: Tungjatjeta, tungjatjeta – Andreas.

Andreas: Ç'ishte kjo? Thirri dikush emrin tim?

Ex: Po, unë! Ja ku jam përsëri!

Andreas: Eksa? Eksa? Ti je?

Ex: Po, unë jam. Nuk më njeh më?

Andreas: Natyrisht që të njoh! Po ti gjithmonë je e padukshme! Më thuaj, çdo gjë në rregull me ty?

Ex: Patjetër! Unë ndihem mrekulli, shumë mirë, në gjendje fantastike, të shkëlqyer ...

Andreas: Mirë fare, mirë fare! E dëgjoj që je akoma Eksa e mëparshme,  
e padukshme dhe ...  
Ex: E paturpshme.

*Andrea dhe Eksa bisedojnë për vitoret Hajncelmenhen. Eksa nuk i tregon Andreas se ajo i ka takuar vitoret e vogla. Andrea e ngushëllon Eksën duke i thënë se Hajncelmenhen në të vërtetë nuk ekzistojnë. Ata janë veçse personazhe të krijuara, imagjinare.*

Andreas: Eksa, ku ishe për caq kohë?  
Ex: Po kërkoja Hajncelmenhen.  
Andreas: Edhe? I gjeje?  
Ex: Jo, nuk ishin më atje.  
Andreas: Natyrisht se nuk ishin, Eksa – Hajncelmenhen janë thjesht një histori e shpikur.  
Ex: Po unë? Dhe unë thjesht një histori jam?  
Andreas: Këtë nuk e di akoma. Ti ekziston, por unë nuk të shoh!  
Ex: Mos provo ta bësh! Ti e di që edhe gruaja e roboqepësit donte t'i shihte Hajncelmenhen.  
Andreas: E di. Ajo përhap bizele.  
Ex: Dhe pastaj të gjithë Hajncelmenhen u zhdukën.  
Andreas: Po unë, Eksa, nuk përhap bizele. Ti nuk duhet të zhdukesh më kurrë!

## Mësimi 16

### Por sot gjërat kanë ndryshuar

*Eksa dhe Andrea janë duke udhëtuar me tren, nga Këlmi për në Berlin. Ata bipin në tren në Këln dhe shobin Katedralen e famshme të Këlnit. Ndërtimi i Katedralës së Këlnit filloi në vitin 1248. Punimet rifilluan në vitin 1560, dhe Katedralja e Këlnit përfundoi së ndërtuari në vitet 1842–1880. Katedralja është fare pranë stacionit kryesor bekurudhor të Këlnit. Që këtej treni kalon në urën mbi lumin Rin.*

Andreas: Eksa, jemi me fat! Shiko, kjo kabinë është fare bosh.  
Ex: Unë dua një vend tek dritarja.  
Andreas: Po natyrisht!  
Ex: Mrekulli! Ne po udhëtojmë tani! – Po kjo, çfarë është?  
Andreas: Kjo është katedralja.  
Ex: Sa e bukur që është!  
Andreas: Dhe sa e vjetër që është.  
Ex: Shiko, po udhëtojmë mbi ujë.  
Andreas: Ky është lumi Rin. Ti e ke parë edhe më parë.

*Nga Këlmi, Eksa dhe Andrea kalojnë përmes zonës industriale të Rurit. Deri në vitet 1970 kjo ishte zona më e rëndësishme industriale e Gjermanisë. Eсени dhe Bobumi ishin qytete të prodhimit të qymyrit, me shumë miniera. Edhe industria e çelikut (Krupp) mbështetej gjithashtu në këtë rajon. Sot rajoni i Rurit nuk është më zonë industriale, me ambjent të ndotur. Në këtë rajon sot ka shumë universitete, ai është shndërruar në një qendër të madhe kulturore (të filmit, të teatrit, të muzeve). Rajoni i Rubrit sot është qendër e rëndësishme kërkimore në fushën e teknologjisë së ambjentit.*

Shefi i trenit: Esen, stacioni kryesor!  
 Bohum, stacioni kryesor!  
 Dortmund, stacion kryesor!

Ex: Sa shumë qytete!

Andreas: Po, këtu ka shumë industri, këtu jetojnë edhe shumë njerëz.

Ex: Industri?

Andreas: Po, në të kaluarën këtu ishte përqëndruar shumë industria e çelikut dhe e hekurit. Por sot gjërat janë ndryshe. Këtu vazhdon të ketë industri, por nuk nxirret aq shumë qymyr. Në Bohum ndërtohen makina. -Dhe në Dortmund prodhohet akoma birra. Dhe qielli nuk është më gri, por sërish blu!

*Landi federal i Nordrajn-Westfalisë nuk është vetëm një qendër industriale. Mynsterlandi është një zonë bujqësore, ku rriten shumë derrra e kuaj.*

Ex: Shiko, në fusha ka derrra dhe kuaj!

Andreas: Natyrisht, tashmë jemi në Vestfali. Këtu nuk ka gati fare industri. Ky land është më tepër qendër bujqësore.

*Eksa do të dijë, sa do të zgjasë akoma udhëtimi për në Berlin.*

Shefi i trenit: Bielefeld – stacioni kryesor. Hannover-stacioni kryesor.

Ex: Edhe sa kemi për të udhëtuar?

Andreas: E di, është udhëtim i gjatë. Por kemi bërë pothuajse gjysmën e rrugës.

Ex: Sa na duhet të udhëtojmë akoma?

Andreas: Edhe katër orë. Eja të shkojmë në vagonin-restorant.

*Eksa mërzhitet. Kur vësbron nga dritarja e trenit, asaj i duket se sheh gjithnjë të njëjtin peizazh: pyje, lumenj, livadhe...*

Ex: Po këtu paska vetëm pyje, lule dhe lumenj!  
 Nuk paska qytete, vetëm fshatra! Kjo është e mërzhitshme!

Andreas: Atëherë fli pak.

*Eksa fle dhe zgjohet pak para se treni të mbërrijë në Berlin.*

Shefi i trenit: Potsdam – Potsdam.

Ex: Arritëm?

Andreas: Jo, po stacioni tjetër është Berlina.

Ex: Më në fund!

## Mësimi 17

### Një valixhe e kam ende në Berlin

*Në këtë mësim kemi përgatitur një montazh situatash tingullore për Berlinin. Montazhi do t'ju japë një përshtypje për Berlinin në të kaluarën dhe sot.*

Në këtë montazh mund të dëgjoni:

1. Një pjesë muzikore të viteve Tridhjetë, regjistruar në Berlin. Fjala është për “Das Spatzenkonzert” të Peter Igelhoff -it.
2. Këngën e famshme “Das ist die Berliner Luft” të kënduar nga Lici Valdmyler (Lizzi Waldmüller) në vitet Tridhjetë.
3. Një këngë nga Comedian Harmonists – një grup i njohur varieteteje, i cili dha shfaqje në teatro të ndryshme në vitet Tridhjetë. Disa nga këngët e tyre siç është kënga “Mein kleiner grüner Kaktus” janë akoma të njohura edhe sot. Në vitin 1934, këtij grupi iu ndalua të jepte shfaqje, sepse tri nga anëtarët e tij ishin hebrenj.
4. Një fjalim në radio të shkrimtarit gjerman Tomas Man (1875–1955), që emigroi në Zvicër më 1933. Në vitin 1939 ai emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku në vitin 1944 mori edhe nënshitetësinë amerikane. Fjala në radio e Manit u transmetua më 10. 5. 1945, dy ditë pas kapitullimit të Gjermanisë. (Fjalën e Tomas Manit nuk po e japim të përkthyer për arsye të mbrojtjes të së drejtës së autorit.)
5. Në vitin 1949 Gjermania u nda në dy shtete, në Republikën Federale Gjermane dhe në Republikën Demokratike Gjermane. U nda edhe qyteti i Berlinit. Më 1961 u ngrit Muri i Berlinit. Më 24. 10. 1950, gjenerali amerikan Klej u dhuroi berlinezëve “një kabanë të lirisë”. Ajo u var në bashkinë e qytetit Shëneberg dhe për një kohë të gjatë i binin çdo ditë në orën 12.00. Më 26. 3. 1963 në Berlin erdhi presidenti amerikan Xhon F. Kenedi. Nga kulla e bashkisë së Shënebergut, ai tha fjalinë që do të bëhej e famshme:  
John F. Kennedy: Ich bin ein Berliner (Unë jam berlinez).
6. Berlinezët janë të njohur për humorin dhe komunikimin e tyre të shpenguar. Dialogu i mëposhtëm, në origjinal në dialektin berlinez, tregon sensin e tyre të humorit.  
Berlinezja: Mund të shkosh të bësh pazar?  
Berlinezi: Çfarë të bëj?  
Berlinezja: Pazar.  
Berlinezi: Unë? Si kështu?  
Berlinezja: E pse jo?  
Berlinezi: Unë nuk kam qejf.  
Berlinezja: As unë.  
Berlinezi: Mjaft, besoj se mjafton, apo jo??
7. Berlini gjithmonë ka qenë një qytet ku janë takuar kultura të ndryshme. Në Berlin jetojnë shumë të huaj. Deri sa ra Muri i Berlinit, shumë nga të huajt që vinin në Berlin ishin turq. Ju dëgjuat një dialog në gjuhën turke. Ja edhe përkthimi i tij.

Turkesha: Mirëdita.  
 Turku: Mirëdita. Çfarë dëshironi?  
 Turkesha: Një \*Döner.  
 Turku: Urdhëroni – ju lutem.

\* Döner: *Simite ose panine e mbushur me mish të grirë dashi.*

8. Marlene Ditrih, këngëtarja dhe aktorja e njohur gjermane, u bë e famshme për rolin e saj në filmin *“Der blaue Engel”* (Ëngjëlli blu), i cili u prodhua në vitin 1930. Në vitin 1936 ajo u largua nga Gjermania për të jetuar në Amerikë. Më 1941– pasi SHBA hynë në Luftën e Dytë Botërore – ajo veshi uniformën ushtarake amerikane dhe argëtonte me këngët e saj ushtarët amerikanë të vendosur në Evropë. Deri sa vdiq në vitin 1992, ajo jetonte në Paris. Pas ribashkimit të Gjermanisë, ajo shprehu dëshirën që të varrosej në Berlin. Ky regjistrim i këngës *“Ich hab' noch einen Koffer in Berlin”* (Një valixhe e kam ende në Berlin) u bë në vitin 1948. (Për arsye të së drejtës së autorit, teksti nuk është përkthyer nga gjermanishtja)

## Mësimi 18

### Stacioni hekurudhor “Kopshti zoologjik”

*Andrea dhe Eksa arrijnë në stacion hekurudhor “Bahnhof Zoo” të Berlinit. Njoftim me altoparlant: Berlin – Stacioni hekurudhor “Kopshti zoologjik”.*

Andreas: Eja, Eksa, duhet të zbresim.  
 Ex: Pse? Do të shkosh në Kopshtin Zoologjik?  
 Andreas: Jo, ky është vetëm emri i stacionit.  
 Ex: Pse quhet kështu?  
 Andreas: Sepse kopshti zoologjik është fare pranë stacionit.  
 Ex: Një kopsht zoologjik në mes të qytetit?  
 Andreas: Po, sepse Kopshti Zoologjik është 150 – vjeçar. Dhe në atë kohë Berlini nuk ishte kaq i madh.  
 Ex: E pse?  
 Andreas: Pse, pse banania është e harkuar? (*Shprehje idiomatike që përdoret për pyetje pa përgjigje logjike, si p.sh. në gjubën shqipe “Pse java ka shtatë ditë?”*)  
 Ex: Nuk e di.  
 Andreas: Sepse ti bën shumë pyetje! Tani eja të shkretën!

*Eksa zbulon Gedächtniskirche, një kishë, që shërben si kujtesë për Luftën e Dytë Botërore. Andrea dëshiron të takojë sa më shpejt shokët e tij.*

Ex: Shiko, kisha qenka shkatërruar!  
 Andreas: Po, ajo është gërmadhë.  
 Ex: Pse?  
 Andreas: Kisha u shkatërrua gjatë Luftës. Dhe u la gërmadhë, në kujtim të luftës. Kështu donin berlinezët.  
 Ex: Futemi brenda?  
 Andreas: Jo, Eksa, jo tani. Tani do të shkojmë në Kantstraße.



Ex: E pse?  
 Andreas: Sepse atje do të kalojmë natën. Atje banojnë shokët e mi.  
 Ex: Po dr. Tyrmani?  
 Andreas: Atij do t'i telefonoj më vonë.

## Mësimi 19

### Gëzohem që keni ardhur në Berlin

*Andrea i telefonon dr. Tyrmanit për të lënë një vend takimi. Ata vendosin të bëjnë një shëtitje në Berlin me autobusin nr. 100. Autobusi niset nga Bahnhof Zoo për në Alexanderplatz, në Berlinin e mëparshëm lindor dhe kalon para shumë pikave interesante të qytetit.*

Andreas: Mirëmbërëma, dr. Tyrman. Jam Andrea Shefer.  
 Dr. Thürmann: Mirëmbërëma, zoti Shefer. Keni ardhur Berlin?  
 Andreas: Po. Ne mund të qendrojmë në Berlin një javë.  
 Dr. Thürmann: Gëzohem që keni ardhur në Berlin.  
 Andreas: Ne po qendrojmë me shokët e mi.  
 Dr. Thürmann: A thatë ne?  
 Andreas: Ah, ju nuk e dini se Eksa është kthyer përsëri.  
 Dr. Thürmann: Kjo më gëzon shumë! Çfarë do të bëni nesër?  
 Andreas: Mendoj që të vizitojmë Berlinin.  
 Dr. Thürmann: Unë do të kisha një propozim: Ne mund të bëjmë së bashku një shëtitje me autobusin nr. 100. Ai niset nga Kopshti Zoologjik për në Aleks. Është një shëtitje shumë e bukur nëpër Berlin.  
 Ex: Aleks? Kush është Aleks?  
 Andreas: Është një shesh, Alexanderplatz (*Sbeshi Aleksandër*). Më falni, dr. Tyrman.  
 Dr. Thürmann: Në rregull. Takohemi nesër në orën 10 tek Stacioni "Kopshti Zoologjik".  
 Andreas: Dhe ku saktësisht?  
 Dr. Thürmann: Në stacionin e autobusit, dakord?  
 Ex: Dakord.  
 Andreas: Atëherë, mirupafshim nesër!

*Eksa ngazëllehet kur mëson se objekti, që asaj i është dukur si ëngjëll, në të vërtetë është statuja e perëndeshës së fitores, në majë të Kolonës së Fitores. Kolona e fitores u ndërtua në vitin 1871, për të përkujtuar Luftën Franko – Prusiane dhe themelimin e Perandorisë Gjermane.*

Ex: Shiko, atje lart është një ëngjëll.  
 Dr. Thürmann: Eksa, ajo është Kolona e Fitores.  
 Ex: Pse quhet kështu?  
 Andreas: Eksa, ti e di që ndodhin luftëra – fatkeqësisht.  
 Dr. Thürmann: Dhe në të kaluarën kishte gjithashtu luftëra. Kolona e Fitores është një kujtim për një fitore në fund ë luftës Franko-Prusiane.  
 Andreas: Kjo ndodhi shumë kohë më parë, më 1871.  
 Ex: Po pastaj?

Dr. Thürmann: Kjo ndodhi kur u themelua Gjermania.  
 Ex: Si kështu? Nuk ekzistonte Gjermania para kësaj?  
 Andreas: Po, por në një formë tjetër. Përbëhej nga shumë shtete të vegjël. Nuk ishte një shtet i vetëm.  
 Dr. Thürmann: Dhe që nga viti 1871 e këtej Berlini ishte kryeqyteti i Gjermanisë.  
 Ex: Ishte apo është?  
 Andreas: Të dyja.  
 Ex: Këtë nuk e kuptoj ...

## Mësimi 20

### Para se të ndërtohej muri, ...

*Andrea i shpjegon Eksës se pas Luftës së Dytë Botërore Gjermania u nda në dy shtete. Qyteti i Berlinit gjithashtu u nda në Berlinin Lindor dhe në Berlinin Perëndimor. Pas ribashkimit, Berlini u shpall përsëri kryeqytet i Gjermanisë. Deri në vitin 2000, qeveria gjermane do të jetë transferuar nga Boni në Berlin.*

Ex: A është Berlini kryeqytet, apo jo?  
 Andreas: Me pak fjalë: Berlini ishte kryeqytet deri në vitin 1945. Pas kësaj kishte dy shtete gjermane, Republika Federale e Gjermanisë (RFGJ) dhe Republika Demokratike e Gjermanisë (RDGJ). Për sa kohë që ekzistonin të dyja shtetet gjermane, kryeqytet i RFGJ ishte Boni, kurse kryeqyteti i RDGJ ishte Berlini.  
 Ex: Po sot?  
 Andreas: Që prej ribashkimit të Gjermanisë, më 1990, Berlini është përsëri kryeqyteti i Gjermanisë.  
 Dr. Thürmann: Më falni, zoti Shefer: Përpara se të shkojmë më tej, do të doja t'ju tregoja Portën e Brandenburgut. Ejani të zbrisim këtu.

*Dr. Tyrmani i tregon Andreas për murin e Berlinit, që e ndau qytetin prej vitit 1961 deri më 1989.*

Dr. Thürmann: Kjo është pra Porta e Brandenburgut. Dhe ky është vendi ku ishte muri. Kur erdha unë në Berlin, Muri nuk ekzistonte. Dhe pastaj, papritur, brenda natës, Muri u ndërtua. Ishte e tmerrshme. Para se të ndërtohej muri, ky ishte një vend me shumë lëvizje. Ti mund të shkoje përmes Portës së Brandenburgut nga Lindja në Perëndim dhe nga Perëndimi në Lindje. Por pastaj, papritur, kjo u ndalua. Muri qëndroi këtu për gati 30 vjet. Papritur nuk kishe më mundësi të vazhdoje rrugën. Rrugët thjesht ishin të mbyllura.

Ex: Unë s'e shikoj fare Murin.  
 Dr. Thürmann: Ai është i padukshëm, si ti, Eksa. Ai është vetëm një kujtim ...  
 Një shitës berlinëz: Një copë Muri, pjesa juaj, një suvenir, një copë Muri, vetëm tre marka. Bli një copë Muri tani, para se të jetë tepër vonë!

## Mësimi 21

### Çdo gjë po shtrenjtohet tepër

*Andrea interviston disa berlinezë dhe i pyet ata se ç'mendojnë për vendimin e Bundestagut (Parlamentit Gjerman), që Berlini të bëhet përsëri kryeqyteti i Gjermanisë. Një grua nga Berlini mendon se kjo është një ide shumë e mirë.*

- Andreas: Berlino do të bëhet edhe njëherë kryeqytet i Gjermanisë. Ç'mendoni ju për këtë?
- Berlinezja: Ç'mendoj unë për këtë? Mrekullia vetë! Më në fund prapë një metropol.

*Andrea interviston pastaj një burrë nga Berlino. Ai vë në dukje disavantazhet e vendimit.*

- Berlinezi: Ky vendim nuk më duket fare i mirë. Banesat po shtrenjtohen, ushqimet, udhëtimi me autobus – çdo gjë po shtrenjtohet tepër. Mendoj se ky vendim sjell vetëm disavantazhe.

*Pas kësaj Andrea bisedon me një shofer taksie, i cili mendon se ricaktimi i Berlinit si kryeqytet sjell shumë avantazhe. (Fjalët e shoferit të taksisë në origjinal janë në dialektin e Berlinit.)*

- Shoferi i taksisë: Si shofer taksie unë nuk kam asgjë kundër këtij vendimi. Unë do të fitoj ca para më shumë. Dhe Berlino do të bëhet ndërkombëtar. Mendoj se do të më duhet të mësoj gjuhë të huaja...

*Një grua e moshuar flet për rëndësinë e këtij vendimi për Evropën.*

- Gruaja e moshuar: Mendoj se është një vendim i mirë, shumë i mirë madje. Dhe e dini pse? Sepse është i mirë për Evropën. Berlino ndodhet në Evropën Perëndimore dhe në të njëjtën kohë është shumë në Lindje. Kështu Berlino mund të bëhet një urë për në Lindje.

*Një i ri drubet se Berlino do të humbasë atmosferën e tij të veçantë, si një qytet liberal, "alternativ."*

- I riu: Mendoj se vendimi nuk është aspak i mirë. Ajo atmosferë liberale që ekziston tani do të zhduket shpejt. Në erdhëm në Berlin, sepse jeta këtu ishte kaq e pakufizuar dhe liberale. Kjo të duket absurde, por ne me të vërtetë kishim shumë liri në Berlin!

## Mësimi 22

### Berlin Aleksandërplac

*Andrea u shkruan një letër prindërve. Në të ai përshkruan përshtypjet që ka për Aleksandërplac të Berlinit.*

Andrea shkruan: Të dashur prindër, sot isha në Berlinin Lindor, në të famshmin Aleks. Që larg mund ta shikosh kullën televizive. Ajo është 365 m e lartë! Por për të folur hapur: unë u zhgënjeva. Aleks është i madh, një shesh kolosal, por tepër bosh. Nuk qarkullojnë makina, vetëm disa këmbësorë shëtisin nëpër të. Natyrisht, e di se Aleks ka ndryshuar shumë që nga viti 1964. Në atë kohë atje u ndërtuan ndërtesa shumëkatëshe, si hoteli “*Stadt Berlin*”, që është madhështor, por i shëmtuar – ashtu siç janë edhe ndërtesat e tjera shumëkatëshe ... Por në stacionin hekurudhor Aleksandërplac para syve ke një pamje krejt tjetër. Po, stacioni i vjetër ekziston akoma. Dhe është plot jetë. Jashtë ka shumë kioska, që shesin çdo gjë të mundshme: rroba, enë, fruta, perime, ushqime ... A e dini pse ky shesh quhet Aleksandërplac? Nuk e dini. Mirë, e di unë. Kur cari rus Aleksander i Parë vizitoi në vitin 1805 mbretin prusian në Berlin, për nder të tij sheshit iu dha emri Aleksandërplac.

*Andrea përfytyron si dubet të ketë qenë jeta në Aleksanderplac në kohët e mëparshme.*

Andrea vazhdon letrën: Më parë, Aleksandërplac ishte qendra e vërtetë e Berlinit. Nëntë rrugë përfundonin këtu dhe kudo kishte njerëz. Ata ishin në rrugë duke shitur prodhimet e tyre – gazeta, cigare, rroba, qymyr, dru ... Ata i gjeje nëpër pijetore, duke pirë birrë dhe duke folur ... Ata punonin shumë. Ku i gjeta unë gjithë këto detaje? Bleva librin e Alfred Dëblinit, “*Berlin Alexanderplatz*”. Në të bëhet fjalë për një tregtar të thjeshtë në Aleks. Ai donte më shumë nga jeta, se sa vetëm bukë dhe gjalpë ... Është e kuptueshme, apo jo? Sonte do të shoh filmin e regjisorit Fasbinder “*Berlin Alexanderplatz*”. Siç e kuptoni, po ia kaloj mirë këtu.

Me shumë dashuri  
Juaji Andrea

## Mësimi 23

### Spitali i famshëm *Sbarité*

*Andrea, Eksa dhe dr. Tyrmani janë në Berlinin Lindor. Ata kanë qendruar përpara Sharitësë, një spitali të famshëm, ku dikur punonte dr. Tyrmani. Ata vrasin mendjen se pse spitali ka këtë emër.*

- Ex: Shiko, atje lart, shkronjat e mëdha. (*lexon:*) *Cha-ri-të*.  
Andreas: *Sbarité*, Eksa, *Sbarité*.  
Dr. Thürmann: Po, ky është i famshmi *Sbarité*, një spital me famë botërore. Edhe unë kam punuar dikur këtu.  
Andreas: Pse spitali quhet *Charité*?  
Dr. Thürmann: Këtë as unë nuk e di saktë, mund ta marr vetëm me mend: *Sbarité* është shumë i vjetër, gati 300 vjeçar. Dhe më 1710, kur u themelua spitali, në Berlin dihet se kishte shumë francezë.  
Ex: Pra, *Charité* është fjalë frënge?  
Andreas: Po.  
Ex: Dhe çdo të thotë?  
Andreas: Bamirësi, mëshirë.  
Ex: Urdhëro?  
Andreas: Të ndiesh keqardhje, të ndihmosh të sëmurët.

*Dr. Tyrmani shpjegon historinë e Sharitësë.*

- Andreas: Dhe pse është kaq i famshëm *Sbarité*?  
Dr. Thürmann: *Sbarité* ishte një qendër kërkimore me famë botërore. Qysh herët këtu bëheshin operacione të vështira. Dhe jo vetëm kaq. Në *Sbarité* bëheshin kërkime të pavarura. Këtu punonin mjekë shumë të mirë, shumë prej të cilëve morën çmime Nobel.  
Andreas: Por tani çdo gjë duket shumë e vjetër.  
Dr. Thürmann: Natyrisht! Në kohën e nazizmit, shumë mjekë hebrenj u detyruan të largohen, dhe më vonë shumë mjekë të tjerë u larguan për në Perëndim. Vazhdonin të ekzistonin aparatet moderne dhe standartet e mira mjekësore, por nuk bëhej punë kërkimore si më parë.  
Andreas: Po sot?  
Dr. Thürmann: Kam dëgjuar se disa mjekë të rinj kanë ndërmarrë një iniciativë. Ata duan ta ringjallin këtë spital të vjetër dhe me tradita.  
Andreas: Një frymë e re në mure të vjetra?  
Dr. Thürmann: Po, mund të formulohet në këtë mënyrë.

## Mësimi 24

### Të vdekurit nuk janë gjithmonë të vdekur

*Andrea dëshiron të vizitojë të famshmen Dorotheenfriedhof (Varreza e Dorothesë) në Berlin Lindor. Atje janë varrosur ndër të tjera filozofët Fichte (Fichte) dhe Hegel, shkrimtarët Bertolt Brecht (Brecht) dhe Hajnrih Man (Heinrich Mann), muzikanti Hans Ajsler (Hans Eisler), aktorja Helene Vajgel (Weigel) ... Eksa dhe Andrea ecin përmes varrezës. Eksa do të dijë se çfarë i duket interesante Andreas në këtë vend.*

Andreas: Dua të shkoj sot në *Dorotheenfriedhof*.  
 Ex: Në varreza?  
 Andreas: Atje ku janë varrosur të vdekurit. Nuk e di ti?  
 Ex: Dhe çfarë do të bësh atje, me njerëzit e vdekur? Me të vdekurit nuk flitet dot!  
 Andreas: Oh, Eksa! Si të ta shpjegoj unë ty? Të vdekurit nuk janë gjithmonë të vdekur, disa vazhdojnë të jetojnë: në kujtesën time, në këngët e tyre, në tekstet e tyre. A do të vish?  
 Ex: Po, do të vij për të parë. Nuk kam qenë kurrë në ndonjë varrezë.

*Eksa lexon emrat në pllakat e varreve. Në transmetimin radiofonik të kursit të gjuhës ju dëgjoni fragmente nga veprat e disa njerëzve të famshëm, të cilët janë varrosur në këtë varrezë.*

Ex: (*lexon:*) Johann Gottlieb Fichte, 1762–1814  
 Ex: (*lexon:*) Georg Wilhelm Hegel, 1770–1831  
 Ex: (*lexon:*) Bertold Brecht, 1898–1956  
 Andreas: (*citon nga poema e Brehtit "Atyre që do të lindin më pas"*)  
 Ex: (*lexon:*) Helene Weigel-Brecht, 1900–1971  
 Fragment muzike: Helene Weigel këndon këngën e Nënë Kurajës nga drama e Bertold Brehtit "Nëna Kurajë dhe fëmijët e saj".  
 Ex: (*lexon:*) Hanns Eisler, 1898–1962

*Fragment muzike: Tereze Gize (Therese Giehse) këndon "Balada e qerbullit" nga drama e Bertolt Brehtit "Kokërrumbullakë dhe kokëmemajë", me muzikë të Hans Ajlslerit.*

Ex: (*lexon:*) Heinrich Mann, 1871–1950  
 Fragment: Romani "Professor Unrat" i Hajnrih Manit shërbeu ndër të tjera në vitin 1930 si bazë për filmin "Ëngjëlli Blu". Marlenë Ditrigh (*Dietrich*) këndon në këtë film këngën "Mendjen e kam vetëm tek dashuria".

## Mësimi 25

### Në fillim shpresoj të marr porosi të vogla

*Andrea dhe dr. Tyrmani bisedojnë për planet e tyre të ardhshme. Dr. Tyrmani e pyet Andream, nëse do t'i pëlqente të kryente punë kërkimore për një libër që po shkruan për mjekësinë alternative.*

Dr. Thürmann: Pra, edhe njëherë, mirëerdhët në Berlin! Ju lutem, uluni!  
 Ex: Edhe unë?  
 Dr. Thürmann: Po, edhe ti, ti e padukshmja! Kemi parë shumë në Berlin, por për veten tonë nuk kemi folur fare. Si keni qenë? Si ecin studimet tuaja?

Andreas: Falemnderit, unë jam mirë- dhe së shpejti do të përfundoj edhe studimet.

Dr. Thürmann: Po pastaj? Pastaj çfarë do të bëni?

Andreas: Nuk e di ende. Po mendoj të punoj në gazetë ose radio. Në fillim shpresoj të marr porosi të vogla.

Dr. Thürmann: Ndoshta mund të më ndihmoni edhe mua në punën time?

Andreas: Me gjithë dëshirë!

Dr. Thürmann: E dini, unë dua të shkruaj një libër, një libër për mjekësinë alternative.

Andreas: Çfarë do të thotë kjo?

Dr. Thürmann: E kam fjalën për homeopatinë. Unë jam i bindur se njeriu mund të shërohet me ilaçe prej bimësh natyrore. Do të donit të bënit disa kërkime për mua - të intervistonit mjekë, pacientë, të gjenit artikuj?

Andreas: Kjo do të më pëlqente. Por ju duhet të ma shpjegoni me saktësi se ç'përfshin kjo punë.

*Dr. Tyrmani flet për pacientët e tij - dhe lë të kuptojë se ai mund ta bëjë Eksën të dukshme...*

Andreas: Ju thatë se edhe ju keni punuar në spitalin *Charité*.

Dr. Thürmann: Po, por që atëherë kanë kaluar shumë kohë. Atëherë unë isha akoma i ri.

Andreas: Po çfarë pune bënit ju atje?

Dr. Thürmann: Shumë, shumë punë! Kisha klinikën time private, siç e kam edhe sot. Kam ende shumë pacientë, të rinj dhe të vjetër. Kjo është diçka shumë e bukur.

Ex: Pacientët janë të bukur?

Dr. Thürmann: Jo, Eksa, nuk është kjo ajo që doja të thoja. Puna është e bukur. Unë mund t'u ndihmoj njerëzve - ndoshta edhe ty!

Ex: Mua? Pse mua?

Dr. Thürmann: Mbase mund të të bëj të dukshme?

Ex: Jo, jo, unë dua të mbetem e padukshme.

Andreas: Po unë do të doja të të shihja njëherë!

Ex: Po unë nuk dua të më shohësh!

## **Mësimi 26**

### **Ne duam vetëm të jemi bashkë**

*Në këtë mësim do të dëgjoni një këngë nga këngëtari gjerman Udo Lindenberg. Teksti i këngës nuk jepet i përkthyer për të mbrojtur të drejtën e autorit.*